



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 52, datë 24 .12. 2012

PËR

“NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHIAK NR.3, DATË 05.02.2007
PËR “SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E
TIRANËS” (I NDRYSHUAR)

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 16, pika 2 e 4, nenit 32, gërma “f” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 11, pikat 5 e 8 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.8756, datë 26.03.2001 për “Emergjencat civile“ (i ndryshuar) dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr.3, datë 05.02.2007 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Në fund të pikës 1. b “*Taksa Vendore mbi Biznesin e Vogël*”, të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.3, datë 05.02.2007 për “Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës” (i ndryshuar), shtohen paragrafët, si më poshtë vijon:

a. Përrjashtohen nga pagesa e Taksës Vendore mbi Biznesin e Vogël, për një vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, 30 subjektet e biznesit të vogël, që u dëmtuan nga veprimi i forcës madhore (zjarri që ra në tregun ushqimor me shumicë, pranë ish Kombinatit Ushqimor Tiranë), sipas listës si më poshtë:

Lista e subjekteve që janë dëmtuar në tregun ushqimor

Nr	Emër	Mbiemër	Sipërfaqe	Vlera
1	Tomorr	Jaupi	25 m ²	402602
2	Edmond	Caka	18 m ²	265346
3	Shpresa	Çela	17 m ²	251 797
4	Elton	Broci	21 m ²	340 095
5	Albert	Muça	18 m ²	265 346
6	Mark	Marku	18 m ²	265 346
7	Gjergj	Prendi	17 m ²	263 120
8	Pranvera	Halilaj	18 m ²	265 346
9	Arben	Hasa	44 m ²	446 954
10	Agim	Ponari	18 m ²	265 346
11	Flamur	Demneri	36 m ² (10%)	34 338

12	Edmond	Hoxha	13 m ²	197 448
13	Klajdi	Mazreku	18 m ²	265 346
14	Nexhi 09		15 m ²	213 889
15	Nazif	Seferi	18 m ²	265 346
16	Resmije	Groni	36 m ²	343 382
17	Lirika	Hysollari	17 m ²	251 797
18	Esat	Veriu	17 m ²	251 797
19	Elton	Gjoka	18 m ²	265 346
20	Jani	Gjysllari	32 m ²	423 278
21	Ardian	Cungu	18 m ²	265 346
22	Florian&Pellumb	Bylyku&Gjana	25 m ²	402 602
23	Pellumb	Duka	22 m ²	317932
24	Albert	Sela	15 m ²	213890
25	Petrit	Preçi	15 m ²	213890
26	Maije	Pishkashi	18 m ²	265346
27	Hajri	Dragoshi	70 m ²	1 024 113
28	Shegere	Saliu	36 m ²	470 558
29	Lubjana	Kaza	10 m ²	137 198
30	Lume	Selmanaj	30 m ²	396 878

b. Përfitojnë lehtësira fiskale subjektet e Biznesit të Vogël me aktivitete luleshitës dhe librashitës me një ulje të detyrimit për Taksën e Biznesit të Vogël, në masën 30%.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimit Strategjik, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI